



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT

Zyra e Koordinatorit Nacional për MIK
Kancelarija Nacionalnog Koordinatora za IUG
IBM National Coordinator's Office



KODI ETIK PËR ZYRTARËT E KUFIRIT

PËRMBAJTJA

1. Domethënia e shkurtesave.....	3
2. Përkufizimet.....	4-5
3. Parathënia.....	6-7
4. Përmbajtja e dokumentit: Neni 1-30	8-20
5. Baza Referuese.....	21-22
6. Shtojca e nënshkrimeve.....	23

1. DOMETHËNIA E SHKURTESAVE

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
DK	Dogana e Kosovës
GRECO	Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GRECO), trup monitoriues i Këshillit të Evropës me seli në Strasbourg (Francë)
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KDA	Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MF	Ministria e Financave
MeM	Marrëveshja e Mirëkuptimit
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
PSO	Procedura Standarde e Operimit
PK	Policia e Kosovës (në këtë dokument shkurtesa PK i ref. Pol.Kufitare)
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar
SIP	Spektori për Inspektimin e Brendshëm
SSP	Spektori për Standarde Profesionale
VPIK	Veterinari i Pikës Inspektuese Kufitare
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZD	Zyra Doganore

2. PËRKUFIZIMET

Zyrtar Kufitar, i referohet secilit zyrtar publik të caktuar, në përgjithësi si PK, DK dhe AUV, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, në pikën e kalimit kufitar ose përgjatë kufirit ose në afërsinë e menjëhershme të atij kufiri që kryen detyrat e kontrollit kufitar, në pajtim me legjislacionin në fuqi. *(për më shumë shih paragrafin 2 të përkufizimeve).*

Person zyrtar, sipas Kodit Penal të Kosovës, nënkupton:

1. Personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror;

1.1 Personi i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik, i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme;

1.2 Personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj.

Person i afërt është çdo person fizik ose juridik, i cili ka pasur ose ka lidhje interesi, pasurore ose personale jo pasurore, me zyrtarin.

Vepra penale, është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Korrupsion, nënkupton çdo keqpërdorim të detyrës zyrtare të sanksionuar me ligj, apo çdo sjellje tjetër të personit zyrtar, personit përgjegjës apo personit tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përfitimi të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin.

Konflikt i interesit, është gjendja e mospajtitimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, kur gjatë ushtrimit të funksionit të tij/saj, zyrtari ose personi i afërt ka interes privat pasuror ose personal jo pasuror, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikon, ose mund të ndikoj në kryerjen në mënyrë të drejtë të funksionit publik, kur gjendet në situata të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve dhe ndalesave apo detyrimeve, sipas dispozitave të këtij ligji.

Interes publik, nënkupton besimin dhe pritjen e publikut për sa i përket vendimmarrjes së paanshme dhe të drejtë të zyrtarëve në ushtrimin e funksionit publik.

Interes privat, nënkuptojmë, interesin privat pasuror ose personal jo pasuror të zyrtarit që mund të ndikojnë në vullnetin e tij në vendimmarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Etika në filozofi është studimi dhe vlerësimi i sjelljes njerëzore në dritën e parimeve morale. Parimet morale mund të shikohen si standardi i sjelljes që njerzit kanë ndërtuar për veten e tyre ose si lënda e shtërngimeve dhe detyrimeve që një shoqëri e caktuar kërkon nga pjestarët e saj.

